

KOLEC TOPALLI

NGA VEPRA “FJALOR ETIMOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE” III

D

davarít fol. “përhap, shpërndaj”. Fjalë krahinore e gegërishtes veriore, që del së pari te Junku (1895). Është formim i brendshëm nga folja *dar* “shpërndaj, përhap”, *darem* “humb, shpërndahem” (Malësi e Madhe) *m’u daritë* me të njëjtin kuptim, nga një formë e saj më e hershme *dvar-it* me kuptimin “humb, zhduk” me prapashtesën *-it* të foljeve. Forma *davarit* nga *dvar-it* ka marrë zanoren *-a-* për lehtësi shqiptimi, me një harmoni vokalike (khs. *çorodit* nga *ç-rod-it*). Foljen *dvar* me kuptimin “humb” e ka Bogdani: *fjalëtë mia nukë kanë me u dvarunë* “verba autem mea non preteribunt”. Folja *dvar* ka dalë nga *vdar* që e ka Budi: *qi të mos vdārem*; kjo nga *bdar*, që e ka Bardhi: *po bdaret, e po bastardhohetë*. Të gjitha këto forma kanë dalë nga evolucioni fonetik i grupit bashkëtingëllor *db-*, që ka kaluar nëpër fazat *db- > bd- > vd- > dv- > d* (*dë + bar > dbar > bdar > vdar > dvar*). Rrjedhoja të fjalës janë: emri foljor *davaritje* e folja *zhdavarit*, ku parashtesa nuk i jep foljes kuptim të kundërt, por ka kuptim intensiv (khs. *biroj ~ zhbiroj*). Mendimi i Çabejt, që e lidh me *daris*, *daroví* e *darovë*, që kanë kuptimin “dhuratë, zakonisht dhurata që i jepet nuses”, nuk vjen afërmendsh. (Çabej SE III 176, Topalli Fërk. 122).

dëbój fol. “përzë, e largoj”; forma joveprore *dëbuhet* “ndërزهet, ndiqet (pela, gomarica, bushtra, macja etj.)”. Është fjalë e mbarë gjuhës, që del me forma të shumta dialektore: *dëboj, tëboj, sboj, zboj, cboj, xboj, bdoj, dvoj, vdoj*. Të gjitha këto janë variante me parashtesa, të formuara nga më e thjeshta *bo-j*. *Dëboj* ka marrë parashtesën *dë-* dhe është përgjithësuar në gjuhë; prej saj ka dalë *tëboj* (Fier). *Bdoj* ka dalë me metatezë nga *dboj*, dhe prej *bdoj* ka dalë *vdoj*, me hapjen e *b-së* në një grup bashkëtingëllor për lehtësi shqiptimi. Nga *vdoj* ka dalë *dvoj* me metatezë; kurse *sboj, zboj, cboj* e *xboj* janë ndërtuar me parashtesën *s-* dhe variantet e saj dialektore. Buzuku, ku fjala del më së pari, ka *bdonj*: *e ata më bdonjinë e endëshkonjinë pā arësye*. Matrënga ka *dbonj* e *sbonj*: *e pas këtij të sbuami; Na të dbuamitë*. Budi ka *vdonj*: *vdon hekurinë ndë plagët me arësye ndierë ke duhetë* (SC). Bogdani ka *dvonj*: *kjenë dnuem jashtë shtëpijet së t atit tyne*. Kësisoj, kjo folje ka ndjekur rrugën e fjalëve të tjera me grupin bashkëtingëllor *db-*; prandaj aty ku ka *borë* ka edhe *boj*, ku ka *dëborë* ka edhe *dëboj*, ku ka *zborë* ka edhe *zboj*. Buzuku që ka *bdorë* ka edhe *bdonj*;

Bogdani që ka *dvorë* ka edhe *dvoj*. Për burimin e fjalës, *boj* është formim me prapashtesën foljore *-o*, nga një rrënjë që mund të ketë qenë *bi-* “dy”, nisur nga çiftimi i kafshëve (*bi + -oj > boj*), me kuptimin “bëj çift”. Kështu, kuptimi i parë ka qenë “ndërzej, ndjek, çiftoj, bëj çift”, prej së cilës dolën kuptimet e tjera. Rrënja *bi* për “dy” gjendet në shqipe te emri *bigë* dhe përjashta shqipes në lat. *bis* “dy herë”. Lidhja me ie. *b^heg^l-* “rend, vrapoj”, gr. φέβομαι “iki”, lit. *būgstu* “trembem” (Çabej) paraqet vështirësi fonetike për t’u pranuar (khs. *djeg*: ie. *d^heg^l-*). Rrjedhoja të fjalës janë: *dëbim*, *dëbues*. (Bugge BB XVIII 1891, 174, Meyer AS IV 44, Jokl IF 37, 1916/17, 119, Walde-Pokorny II 155, Walde-Hofmann I 483, La Piana SLA I Varia 23, Mann Lg. 28, 1952, 32, Çabej SE III 212, Topalli Fërk. 123).

dënesë f. “qarje me ngashërim, gulçim”. Fjalë e gegërishtes, e përgjithësuar në gjuhë. Dëshmohet së pari te Bogdani: *Zani nalt’ kje gjegjunë, i anëkimit, e i vajit, e i dënesmësë së Rahaelit*. Për burimin e saj janë shprehur Meyeri, që e bie nga lat. *nenia* “vajtim, ligje”, dhe Kristoforidhi, që e bie nga sll. *dihanie* duke ndërtuar *ad hoc* formën *dëhnesë*, që nuk ekziston në gjuhë. Çabej nuk mban qëndrim për këto etimologji dhe nuk jep ndonjë mendim tjetër. Është formim i brendshëm i shqipes me prapashtesën *dë-*, rrënjën *ne-* dhe prapashtesën *-së*. Rrënja *ne* mund të jetë emri *nye*, që në trajtën e shquar dhe në shumës del me zanoren *-e* (*neu, neje*). Emri *nye* në një fjalë të tillë përlligjet nga shprehja të tilla, si: *nuk më shkon buka, m’asht lidhë nye; iu lidh një nyjë në grykë (nga ngashërimi), m’u mblodh një lamsh (nye) në grykë*. Dënësja është një vaj me ndërprerje, sikur ndesh në një pengesë, në një nyjë (khs. edhe *nyja e fytit*). Folja *dënes* për “qaj me dënësë” duket më e re dhe e formuar nga emri. Arbëreshët e Italisë kanë *dënesënj*. (Meyer EW 65, Kristoforidhi 79, Çabej SE III 224, Luka I 340).

di fol. “kam njohuri, njoh”. Fjalë e mbarë gjuhës, që lidhet me rrënjën ie. *d^hi-* “shoh, duket”, ku bën pjesë ind. vj. *dhī, dhītī* “mendim, arsye, njohje” (Meyer). Dëshmohet së pari te Buzuku: *Ju nuk dini qish doni me lypunë*. Ky autor ka edhe mbiemrat *i diçëm* e *i ditëshim*. Emrin prejfoljor *dije*, të formuar me prapashtesën e femërore dhe me bashkëtingëlloren *-j-* për zhdukje të hiatit, Budi e ka me formën *die*, prej së cilës është formuar *dies* “dijetar” me prapashtesën e emrave të vepruesit, edhe ky i dëshmuar te Budi. Rrjedhoja të tjera janë: *dijetar*, *dijení*, *dituní / diturí* (rrj. *diturak, dituror*), *dinak* (rrj. *dinakëri, dinakërisht*); kompozita *dijekeq* “i djallëzuar”, që del te Buzuku, me rrjedhjen *dijekeqësi*, geg. VP *dizoti, dishditës* “para një dite” (Bashkimi) etj. Me këtë folje janë krijuar edhe përemrat e ndajfoljet *diçka* e *diç* te Bogdani, *diku* e *dikutek*, *dikur* e *i dikurshëm*, *disa*, *disi*, *dikush*, *dikysh*, arb. e Greqisë *dicili*. Folja *di* del gjithandej me zanore gojore, prandaj bie edhe lidhja me ie.

ġin-, ku bën pjesë lit. *žinau* “njoh”, let. *zinu* “di”, sll. vj. kisht. *znaja, znati* “njoh” (Çabej). Në këtë grup fjalësh shqipja merr pjesë vetëm me foljen *njoh* (ie. *ġnēsšō*). (Meyer EW 66, AS III 29, Brugmann Gr. I² 102, Jokl IF 36, 1915, 112, Sprache IX 2, 1963, 128, Walde-Pokorny I 831, Tagliavini AD 104, Cimochowski LP 2, 1950, 240, Mann Gr. 143, 169, Çabej SE III 237, Demiraj AE 132).

díell m. “trup i zjarrtë qiellor”. Fjalë e mbarë gjuhës dhe e trashëguar, me burim të diskutueshëm. Dëshmohet për herë të parë te Buzuku: *e bukurë porsì ana, e zgi□edhunë porsì dielli*. Fonetikisht, *diell* ka dalë nga një **del-*, që mund të lidhet me rrënjën **m^hel-* “shkëlqen, vezullon” dhe “i verdhë”, ku bëjnë pjesë ind. vj. *hári*, av. *zaray-* “i verdhë”, gr. *χόλος* “vrer”, gjerm. l. vj. *gold* “ar”. Në mbështetje të ngjyrës së verdhë, nga kjo rrënjë ka dalë edhe emri *dyllë* me një shkallë tjetër vokalike (**m^hōl-*) në marrëdhënie të apofonisë kuantitative e kualitative me emrin *diell*. Një mundësi tjetër parashtron Çabej, duke e lidhur *diell* me ie. *d^hel-*, “ndrit, i ndritshëm”, ku bëjnë pjesë ags. *deall* “i shkëlqyeshëm”, nord. vj. *Heim-dallr* “një emër hyjnie”, arm. *delin* “i verdhë, i zbehtë”. Lidhur me përdorimin e fjalës, *Diellë* del si antroponim në Malësi të Veriut. Ka edhe ndonjë toponim me këtë emër (*Qafa e Diellit* ndërmjet Plavës e Gucisë, *Kodra e Diellit* në Tiranë). Rrjedhoja të fjalës janë: *diellor, diellishtë, diellzot, diellzim*, të gjitha krijime të reja (neol.). (Bopp 513, Camarda I 123, Meyer EW 69, Pedersen BB 20, 1894, 238, KZ 36, 1900, 286, Mann Lg. 28, 1952, 36, Gr. 46, Çabej SE III 241).

dje ndf. “dita para së sotmes”. Fjalë e mbarë gjuhës dhe e trashëgimisë indoeuropiane. Lidhet me rrënjën *ġh[dŎ]es, ġhjes* “dje”, ku bëjnë pjesë ind. vj. *hyás*, pers. re *dī*, gr. *χθες*, lat. *heri*, korn. *neihur*, got. *gistradagis*, gjerm. l. vj. *gestre*, sued. vj. *i gār*, dan. *igaar*, të gjitha me kuptimin “dje”. Baza e shqipes ka qenë një **der-*, që e kanë edhe disa gjuhë të tjera (khs. lat. *heri*, sued. vj. *i gār*), ku *-r*-ja fundore ka rënë brenda shqipes, ashtu si te foljet *bie* (**ber-*), *shpie* (**sh-per-*), *shtie* (**ster-*). Prandaj nga **der-* ka dalë *die, dije* (me *-j*- për zhdukje të hiatit), forma që i ka toskërishtja dhe del edhe te Bardhi: *Die* “Heri”; kurse *dje* ka dalë me kthimin e togut zanor në diftong (khs. *bie* > *bjen*). Dëshmohet për herë të parë te Buzuku: *Qysh dje*. Rrjedhoja të fjalës janë: *i djeshëm, pardje, i pardjeshëm; djethin, djethinaj*, dy të fundit në toskërishte. (Meyer EW 69, AS III 84, Pedersen KG I 89, Jokl LKU 26, Walde-Pokorny I 664, Ernout-Meillet 449, Tagliavini AD 103, Mann Gr. 197, Huld BAE 53, Çabej SE III 261, Demiraj AE 138, Topalli Dift. 103).

djep m. “shtrat i vogël për foshnja”. Fjalë e mbarë gjuhës, me etimologji të pasqaruar. Morfologjikisht ka bërë pjesë në paradigmen e emrave femërorë me temë në bashkëtingëllore (*djep* ~ *djepja*), me çka shpjegohet ambigjenia e tij, mashkullore (*djep*) e femërore (*djepë*). Për burimin e fjalës, *djep* mund të jetë huazim nga gr. vj. δέπας “kupë, tas”, meqenëse djepat primitivë kanë qenë bërë nga një copë trangu e gërryer përbrenda, që i ngjan një kupe. Burimi nga rrënja ie. *d^heub^h*- “i thellë” (Çabej) ndesh në vështirësi fonetike (diftongu ie. *-eu-* nuk jep *-je-* në gjuhën shqipe). Rrjedhoja të fjalës janë: *djepës* “fëmija që është ende në djep” (Bregu i Detit), në Lezhë me trajtën *djeps* e në Martanesh *djepsor*; folja *djepoj* “përkund fëmijën”, kompozitat *djepferrosur*, *djepatundur*, *djepshkretuar* me kuptimin “që s’ka lindur fëmijë, që s’ka tundur djep”. Ka depërtuar edhe në patronimi (*Djepaxhiu* e *Djepaxhia*). (Camarda II 191, Meyer EW 69, AS III 18, Pedersen KZ 36, 1900, 333, Jokl IF 36, 1915, 158, Barić Hómje 77, Skok ER III 653, La Piana SLA I 48, Çabej SE III 264).

dókë f. Fjalë me përhapje të gjerë në të dy dialektet dhe me forma e kuptime të ndryshme: “lojë kalamajsh, që luhet me një shkop të gjatë dhe një toptë të drunjtë a një cung druri të rumbullakët”, prej të cilit ka marrë emrin loja, që del me format: *dokë* më e përgjithshme, *dojkë* (Shkodër), *dokë* (Kurvelesh), *droçkë*, *doçe* (Kavajë), *dokthi* (lab.), *dokër* (Myzeqe), *dokërr* (geg. V.), *dokazi* (Korçë), *doçkë*, *dockë* (Gjirokastër), *dojë* e *dojëz* (Mirditë), *droçkël* (Lumë) etj. Me këtë lidhet edhe *dokërr* “kockë e madhe e krahëve a e këmbëve me një pjesë të dalë te kyçet, copë kocke si grusht” dhe “lëmsh, top, send i madh sa grushti”. Në të gjitha këto kemi të bëjmë me një send të rumbullakët në formë të grushtit, domethënë të dorës. Prandaj të gjitha këto kanë si bazë emrin *dorë*, sinonim i grushtit, që ka marrë prapashtesa të ndryshme, duke shkaktuar rënien e lëngëzores (*dokë* nga një **dorkë*, *doçe* nga **dorçe*, *doçkë* nga **dorçkë*); por duke u ruajtur *-r-*ja te *droçkë* e te *droçkël* (nga **dorçkë*) e duke u shndërruar në *-j-* te *dojkë* e *dojë* për të lehtësuar shqiptimin. Janë të gjitha forma krahinore, që kanë marrë zhvillime të ndryshme sipas prirjeve dialektore. Çabej për burimin e kësaj fjale shënon se mbetet ende një çështje e hapët. (Çabej SE III 278, Luka I 354).

dokërr f. “kockë e madhe te kyçet e krahëve a të këmbëve me një pjesë të dalë te kyçet”, “copë kocke si grusht”, “diçka e fortë sa një grusht, e rumbullakosur ose me nyja”, “koçan misri a një copë druri e rumbullakosur, me të cilën luajnë doçen”, fig. “fjalë boshe, të kota, gjepura, pallavra”. Fjalë e dy dialekteve me kuptime të shumta, që bashkohen në kuptimin e përgjithshëm “diçka e rumbullakët në formë grushti”; si rrjedhim burimi i saj mund të jetë emri *dorë* me kuptimin “grusht”. Te *dokërr* ka rënë *-r-*ja para një

bashkëtingëlloreje tjetër ose nga prania e *-rr-së*, me një disimilim në shkallën zero. Lidhet përbrenda gjuhës me *dokë, doçkë, dojkë* etj., që në disa krahina quhet *dokërr* e *dokrras* dhe kanë të njëjtin burim, emrin *dorë*. Forma dialektore *dokël* del në Veri (L. Lukaj, Gazulli). (Camarda I 85, Barić ARS I 8, Meyer EW 70, Çabej SE III 279, Luka I 355).

dómën sh. “dyshim, gjendje ndërduzash”. Fjalë krahinore e gegërishtes, që del për herë të parë te Bogdani: *Prashtu ishte Djalli ndërdomënë* “Era perciò il Demonio in dubio”. E ka Fjalori i Bashkimit: *me e lanë a me metë ndërdomna*; në Malësi të Madhe *jam në domën*; në Pukë *ket fjalë e lamë në domnat*. Përdorimi me parafjalën *ndër* dëshmon se kemi një formë shumësi, meqenëse kjo parafjalë nuk përdoret me njëjës. Këtë e dëshmon edhe forma e fjalës me formantin *-ën(ë)* të shumësit (khs. *etën*). Prandaj tema e fjalës është **dom-*, që lidhet përbrenda gjuhës me variante dialektore të numërorit *dy > dō > do* dhe ka marrë prapashtesën *-m* (khs. *dymëzaj*). Edhe kuptimi i fjalës pajtohet me atë të numërorit *dy*: *jam ndër domna* do të thotë “jam ndë dyshim, jam ndërduzash”. Çabej e lidh me *drom* “rrugë”. (Çabej SE III 283).

drédhëz f. “man toke, lat. *Fragaria vesca*”. Fjalë e mbarë gjuhës me forma të ndryshme nëpër dialekte: *dredhëz*, më e përgjithshme për dy dialektet, *drethë* (Rossi), *drethëzë* në Mallakastër e në arb. e Greqisë, *dreth*, *dërthë*, *dredh* në Krujë, *drethë* e *dorathë* në Malësi të Tiranës, *drethajë* në Mat etj. Të gjitha këto janë formime të brendshme, që kanë si bazë foljen *dredh* dhe kanë marrë prapashtesa të ndryshme, kryesisht me karakter deminutiv. Emërtimi i kësaj bime me foljen *dredh* përligjet, nga njëra anë, për vetë natyrën e degëve të kësaj bime, dhe nga ana tjetër, për emërtimet e shumta të shkurreve të ngjashme me të, që e kanë burimin nga e njëjta folje (khs. *dredhe* e *dredhëz* “një lloj kulpri, lat. *Clematis viticella*”, *drethkëz* e *dredhkël* “dorëzonjë, lat. *Lonicera caprifolium*”). Duke u shpjeguar emri i kësaj bime me mjetet e brendshme të shqipes, një afrim me fjalët kelte *drezen*, *dreizen* “ferrëmanzë”, si një barazim kelto-shqiptar (Pedersen, Çabej), nuk mund të mbahet. (Meyer EW 74, Pedersen KG I 80, Weigand BA 2, 1926, 222, Çabej SE III 310, Demiraj AE 144).

dríthë m. “të lashta”. Fjalë e mbarë gjuhës bashkë me arbërishten e Italisë e të Greqisë; e trashëguar nga fondi indoeuropian, ku lidhet me rrënjën *ǵʰd-* “elb”, prej së cilës kanë dalë lat. *hordeum*, gr. κῆρι, κῆριθή, gjerm. l. vj. *gersta*, të gjitha me kuptimin “elb” (Jokl). Dëshmohet për herë të parë te Buzuku, ku del me gjininë asnjëse: *Kur u rit drithëtë*. Me këtë gjini e kanë

edhe autorët e tjerë dhe të folmet dialektore. Rrjedhoja të fjalës janë: *drithnik* e *drithanik*, *drithërishtë* e *drithnajë*, *drithar* “tregtar drithi” (Tase), *drithatore* “gruaja që përgatiste drithin për ta çuar në mulli”; neol. *drithor*, *drithëtore*. Afrimi i *drithë*-it me *dredhëz*, *dregzë* e *drizë* duke i vendosur të gjitha te rrënja ie. **der-*, *derë* “rrjep, çaj” (Çabej), nuk është bindës. (Jokl IF 1930, 1912, 302, Fest. Kretschmer 1926, 89, Walde-Pokorny I 611, Walde-Hofmann I 457, Ernout-Meillet 459, La Piana SLA Varia 100, Mann Lg. 28, 1952, 40, Huld BAE 55, Ölberg St. Pisani II 1969, 685, Çabej SE III 323, Demiraj AE 145).

dry m. “kyç, çelës”. Fjalë e gegërishtes e përgjithësuar në gjuhë, jo e panjohur në toskërishte, që përdor më shumë *kyç* me burim nga sllavishtja. Dëshmohet së pari te Buzuku: *Mjerëtë ju doktorëtë e ligjsë, përse ju meri drytë e t ditunit*. Ky autor ka edhe formën e shumësit: *e u të t ap dryenëtë e regjënisë qiullet*. Kjo formë gjëllin edhe sot në geg. VL (Kosovë). Budi ka foljen *ndrynj*, që e ka gegërishtja e sotme. Tase ka *sdrymë* (*s-dry-më*) për “katua, vend i mbyllur” nga folja (*n*)*dryj* (khs. *fryj* e *frymë*).

Fjala është formim i brendshëm nga emri *dru*, si mjeti primitiv i përdorur në kohë të lashta para daljes së mjeteve të hekurta të ditëve tona. Këtë burim e dëshmon edhe gjinia asnjane e këtij emri, ashtu si vetë emri *dru*; khs. Buzukun: *drytë e t ditunit* (lat. “*clavem scientiae*”). Me gjininë asnjane shpjegohet edhe forma *dryti* (Kavajë), që përmban një shquese (khs. *ujti*, *kryeti*). Morfologjikisht, *dry* është një shumës i singularizuar nga *drynj*, në një paradigme *dru* ~ *drynj* (khs. *gju* ~ *gjynj*). Forma e shumësit *dryenë* e autorëve të vjetër dhe e gegërishtes VL përmban dy formante shumësi: *dry-e-në*, ashtu si *bri* ~ *brienë*, *krue* ~ *kroenë*, *sy* ~ *syenë*. (Bugge BB XVIII 1891, 165, Walde-Hofmann I 385, Tagliavini AD 109, Jokl Arch. Rom. XXIV 1, 1940, 23, Çabej SE III 339, Demiraj AE 148, Topalli Gr. 288).

dúa / dúe fol. “dëshiroj”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian, që lidhet me rrënjën ie. *gheus-* “shijoj, provoj” ku bëjnë pjesë av. *zaosa* “dëshirë”, pers. vj. *daustar*, pers. re *dost* “mik”, ind. vj. *jusáte* “kënaqet”, gr. γεύω “shijoj”, lat. *gusto*, *-āre* “shijoj”. Raporti ndërmjet së tashmes *dua*, së kryerës së thjeshtë *desha* dhe pjesores *dashur* është i tillë: forma bazë e foljes është e kr. thj. *desha*; pjesorja *dashur* përmban zanoren e ndryshuar me apofoni kualitative (*-e* : *-o* > *-e* : *-a*), kurse e tashmja *dua* ~ *do* përmban zanoren e ndryshuar me apofoni kuantitative (*-e* : *-ē* > *-e* : *-o*). Në formën *dua* togu zanor është krijuar nga mbaresa *-n* e foljeve të së tashmes (khs. *lâ* / *lë* ~ *lashë*), që ka shkaktuar rënien e fërkimores, të ruajtur në të kryerën e thjeshtë *desha* e në pjesores *dashur*. Në formën e së tashmes disa trajta dalin me zanore të diftonguar (*dua* ~ *duam* ~ *duan*), disa të tjera me

zanore të plotë (*do ~ doni*). Nga këto, disa janë krijuar me rrugë fonetike, disa me rrugë analogjike. Në format me diftong, me rrugë fonetike është krijuar e tashmja *dua*, kurse *duam ~ duan*, që nuk janë në kushtet e diftongimit, janë krijuar me shtrirjen analogjike të vetës I njëjës. Në format pa diftong, me rrugë fonetike është krijuar v. II shumës *doni*, më e vjetër *doi*, ku mbaresa *-i* nuk ka lejuar diftongimin e zanores (khs. në sistemin emëror *ftua ~ ftoi*). Forma me mbaresën *-i* ruhet në folklor, khs. në një këngë popullore: *Po ju shokë ndë më doi (në më doni)*, *dy Kuvende të m'i thoi* (Hahn); Variboba: *ju çë doi se m'e nget?* (“che volete se egli me lo tocca”). Prej v. II shumës zanorja e padiftonguar është shtrirë me rrugë analogjike në v. II njëjës e pastaj në v. III, meqenëse në shumë folje këto dy forma janë të njëjta (khs. v. II, III *ban / bën, del, mat* etj.).

Në fjalëformim është treguar prodhimtare pjesorja, që ka krijuar rrjedhojat: *dashje, dashnor* (geg.) e *dashatar, dashas* “me dashje”; *dashuroj, dashuri* e *dashuriçkë* (tosk.), *dashurues* etj. Emri *Dashmir* përdoret si antroponim. (Meyer EW 64, AS III 90, Pedersen KZ 36, 1900, 333, KG 80, Jokl IF 37, 1916/17, 101, Walde-Pokorny I 568, Hirt Gr. I 237, Boisacq 145, Walde-Hofmann I 608, Ernout-Meillet 439, La Piana SLA I 49, Barić Hómje 39, Çabej SE III 173, Demiraj AE 149, Topalli Fol. 421).

dýllë m. “lëndë e butë me ngjyrë të verdhë, me të cilën bletët bëjnë hojet”. Fjalë e mbarë gjuhës duke përfshirë arbërishten e Italisë e të Greqisë. Si emër lënde të pandashme, ka qenë i gjinisë asnjansë. Me këtë gjini del te autorët e vjetër e sot nëpër dialekte; Budi: *e dyellëtë e mjaltëtë kūr vritenë bletëtë*; çam. *bënet dillët*, malësorët e Bregut të Matës *ka dyll*. Sot është integruar në gjini të tjera: përgjithësisht *dylli*, dialektore *dylla, dyllti*. Për burimin e fjalës, *dyllë* mund të jetë emërtuar nga ngjyra e tij e verdhë; prandaj mund të lidhet me rrënjën ie. *ǵ^hel-, ǵ^hōl-* “i verdhë” ku bëjnë pjesë ind. vj. *hári*, av. *zaray-* “i verdhë”, gr. *χόλος* “vret”, gjerm. l. vj. *gold* “ar”. Një lidhje me lit. e let. *dūlis* “mjegull, avull, kem për të përzënë bletët, pishë, fitil”, lat. *fuligo* “thirr, blozë”, gr. *θύος* “kem”, pers. re *dūd* “tym” (Çabej) nuk përlligjet nga ana kuptimore. Rrjedhoja të fjalës janë: *i dylltë* e *i ndylltë* (*bukë e ndylltë* “e trashë dhe e pakulluar mirë”), *dylltak* “njëlloj amfibi që rron në kënetë” (Podujevë); *dylltak* (*tokë dylltake*), *dylltinë, dultë* e *dultinë* (Pukë), *i dyltenjshëm* “mielli i grunit të lagun” dhe *e dylteme* (*bukë e dylteme* “e butë”), *dyllç* “si dyllë” e *dyllçohet* “ngjeshet” (Malësi e Madhe), *dyllos* e *dyllosje, dyllëçit* e *dyllëçitje*, neol. *dyllor* etj. (Camarda I 226, Meyer EW 78, Pedersen KZ 36, 1900, 334, Bartoli Riv. d'Alb. 4, 1943, 231, Ernout-Meillet 401, Walde-Pokorny I 504,

Walde-Hofmann I 563, Barić Hómje 36, Jokl Sprache IX 2, 1963, 154, Mann Gr. 55, Çabej SE III 371, Demiraj AE 152).

DH

dhi f. “kafshë shtëpiake me brirë e me lesh të gjatë”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Lidhet me rrënjën ie. *ǵ^haido* “cjap, dhi”, ku bëjnë pjesë lat. *haedus* “edh”, got. *gaitis*. Për shqipen një bazë **ǵ^hid-*. Hipotezat e tjera, *dhi* : gjerm. *Ziege* (Xylander), *dhi*: ind. vj. *ajāḥ* (Meyer), janë më pak të mundshme. Dëshmohet së pari te Buzuku: *e endë lëkurë en dhishit enveshunë*. Budi ka edhe deminutivin *dhizë*. Rrjedhoja të fjalës janë: *dhiar* e *dhiak* “bari dhish”, *dhiare* “rrugë e ngushtë dhish”, *i dhinë / i dhirë* “prej dhie”, prej kësaj në Vërçë *dhirac*, *dhirackë* “gunë a shtrojë me lesh dhie”, *i dhintë / i dhirtë* e *i dhishtë*, *dhizë* “kec, edh”, *dhishkë* “dele e murrme”, kompozitat *gunëdhirë* (çam.), *mjekërrdhizë* emri i një luleje, lat. *Anthericus ramosus* (Malësi e Madhe). Deminutivi *dhizë* prej shqipes ka depërtuar në dialektet e greqishtes. (Xylander 304, Stier nr. 59, Camarda I 175, Meyer BB 8, 1884, 187, EW 85, Pedersen KZ 36, 1900, 320, Walde-Pokorny I 38, Boisacq 187, Barić Hómje 77, Jokl Sprache IX 2, 1963, 149, SG Rozwadowski 1927, 241, Çabej SE IV 35, Demiraj AE 160).

E

e Trajtë e shkurtër përemri, që përdoret pa dallim gjinie në rasën kallëzore të numrit njëjës (*e mora*). Por kjo trajtë nuk mund të lidhet me përemrin e kësaj rase, që është *atë*, prej të cilit s’ mund të dalë *e*-ja. Historikisht kjo është trajtë e gjinisë femërore të rasës dhanore, ku bashkë me trajtën *i* të gjinisë mashkullore kanë kryer dallimin në gjini, sikurse përemrat e plotë *atij ~ asaj*. Kjo *e* ka dalë nga përemri ie. *Ōā*, që në pozicion të theksuar, në rasën emërore, ka dhënë (*a*)*jo*, kurse në pozicion të patheksuar, në rasën dhanore (sot kallëzore), ka dhënë *e* (Meyer). Në format e bashkuara *ma*, *ta* trajta e shkurtër *e* është bashkuar me zanoren *-ë* të përemrave *më*, *të*; kurse në trajtat e bashkuara *ia*, *ua*, nga *i + e*, *u + e*, ku s’ka pasur një *-ë*, ka vepruar analogjia. Dëshmohet së pari te Buzuku: *ata Tenëzonë nukë e vunë përpara faqesë tyne*. (Brugmann Gr. II² 329, Pedersen KZ 36, 1900, 131, Walde-Pokorny I 97, Walde-Hofmann I 721, Topalli Për. 88).

éja fol. Forma e mënyrës urdhërore të foljes *vij*. Është folje supletive, që del në mënyrën urdhërore *eja ~ eni, ejani*, në një kohë që e tashmja është *vij* dhe e kryera e thjeshtë e pjesorja *erdha ~ ardhur*. Është e vetmja folje që del me tri rrënjë të ndryshme në gjuhën shqipe. Krahasimi i njëjësit me shumësin

(*eja ~ eni*) dëshmon se rrënja është *e*, kurse *-a*-ja është një shtesë zanore, meqenëse rrënja është e pamjaftueshme fonetiki; kurse bashkëtingëllorja *-j*-ka ndërhyrë për të zhdukur hiatin. Shumësi *ejani* është formuar mbi bazën e së tashmes së zgjeruar, por gegërishtja ruan edhe formën më të vjetër *eni* nga rrënja e fjalës. Rrënja *e* nuk është e vetmuar brenda gjuhës. Ajo lidhet me foljen *vete* (*v-e-te*), ku *v*-ja ka hyrë nga e kryera e thjeshtë *vojta / vajta*, si zhvillim fonetik i një *o*-je në ballë të fjalës; si rrjedhim, të dyja foljet kanë një rrënjë *e* me burim të trashëguar, që afrohet me ie. *e* ^ō “shkoj, eci”, ku bëjnë pjesë ind. vj. *ḡti*, av. *aēiti*, pers. vj. *aitiy* “shkon”, lit. *eimi* “shkoj”, gr. *εἴμι*, lat. *eo* “shkoj, vete”. (Camarda I 324, Meyer EW 93, Berneker I 263, Mladenov 161, Tagliavini AD 111, Skok ER I 488, Çabej SE IV 70, Topalli Fol. 437).

end fol. “lëshon vezët miza, pështyn miza mishin”. Fjalë me përdorim krahinor në të dy dialektet (Krujë, Mirditë, Kukës, Shpat etj.). Përdoret si folje dhe si emër sidomos me prapashtesë deminutive, *endëz* për “vemje”. Në Gramsh ka kuptimin “krimb djathi, shtrep”. Lidhet përbrenda gjuhës me *end* “pjaln” nga ngjasimi që kanë vemjet me pjalmin, endin e luleve. Një lidhje me foljen *âjet / ênjtet* (Çabej) paraqet vështirësi fonetike e kuptimore. (Çabej SE IV 80).

endë ndf. “edhe, akoma”. Fjalë dialektore e gegërishtes, që del edhe me format e thjeshtuara *ene, ne*. Përdoret edhe si ndajfolje për “akoma”, edhe si lidhëz për “edhe”. Dëshmohet së pari te Buzuku: *lutëni tenëzonë ende për muo*. E kanë edhe autorët e tjerë dhe është e gjallë nëpër të folme dialektore. Për burimin e saj, një krahasim me *edhe* për mënyrën e formimit (*edh + e*), është i vlefshëm edhe për *ende*, që është formuar nga *end + e*. Elementi i parë gjendet përbrenda gjuhës te ndajfolja *brendë*, e formuar nga *për + endë*, ku *endë* nga rrënja ie. **ent-* krahasohet me gr. *έντός*, lat. *intus* “brendë”; kurse elementi i dytë është lidhëza bashkërenditëse *e*, me të cilën pajtohet nga përdorimi. Forma *ne* ka dalë nga *ende* me një copëzim të fjalës duke e marrë si të formuar nga *e + nde*, ose me rënien e zanores së patheksuar për shkak të pozicionit të patheksuar të fjalës brenda fjalisë. Kësisoj, *n^de* ka dalë nga *ende* njëlloj si *dhe* nga *edhe*. (Meyer EW 83, Hamp Whatmough’s Studies, 1957, 80, Mann Dict. 209, Çabej SE IV 80).

ëndem “sillem andej-kënde”. Fjalë e mbarë gjuhës, pa ndryshime nëpër dialekte. Për burimin e saj, *ëndem* ka dalë nga një kuptim konkret, nga folja *end* “thur pëlhurë, gërshetoj”, veprim që arrihet duke shkuar perin andej-kënde, poshtë-lart. Tek *ëndem* kemi një abstraktim të lëvizjeve që bëhen gjatë thurjes së pëlhurës. Duke u shpjeguar burimi i fjalës brenda shqipes, një lidhje

me gr. ἄνδιφος, si një fjalë ilire te tarentinasit, që del te Heziku (Çabej), nuk mund të mbahet. Rrjedhoja të fjalës janë: *përendet*, *shendet* e *çendet* me kuptim intensiv “sillet e përsillet” (në Shkodër: *endu*, *shendu*), *endje* e *endacak* (Çabej SE IV 81, Demiraj AE 167).

énjte (e) f. “dita e katërt e javës”. Fjalë e mbarë gjuhës, me burim të errët. Ndërsa *e hëna*, *e marta*, *e mërkurra*, *e shtuna* dhe *e diela* janë sqaruar për burimin e tyre, dita *e enjte* dhe *e premte* janë të errta. Forma më e hershme e kësaj fjale ka qenë *e enjete*. Me këtë trajtë e ka Buzuku, ku fjala dëshmohet për herë të parë: *t enjëtenë të së dytësë të diel endë këreshmë*. Gegërishtja veriore ka *e êjte* (-nj- > -j-), kurse toskërishtja jugore ka *e ënjte* (-e- > -ë-). Për hetimin e burimit të fjalës, duhet marrë parasysh se shumica e ditëve të javës ose janë huazime nga latinishtja, ose janë kalke gjuhësore të krijuara sipas modeleve latine. Prandaj, për ditën *e enjte* mund të ketë kuptim fakti se në traditën e kishës romane njihen disa emërtime të veçanta të kësaj dite, si: *e Enjtja e Madhe*, *e Enjtja e flive*, *e Enjtja e Majme*, duke shprehur të gjitha të njëjtën gjë: ditën e fundit para se fillojnë kreshmët, gjatë të cilave nuk hahet mishi e bulmeti. Në këtë ditë besimtarët janë të lejuar të hanë gjithçka dhe derisa të ngopen, sepse të nesërmen fillojnë kreshmët. Prandaj edhe emri i kësaj dite mund të lidhet me foljen *anjem* / *ënjtem* (khs. shprehjen *u aja tue ngranë*). Forma *e enjete* mund të ketë si bazë formën e pashtjelluar *anjë*, që formon emra (khs. *dekë*, *veshë*, *mbathë*). Nyja e përparme *e* ka dalë nga sintagma *dita e enjte*, ashtu si në rastin e ditëve të tjera të javës. Një burim nga një numëror, duke e afruar me gr. vj. ἔβη, si dita e tretë e javës (Mjedja, Çabej), paraqitet i vështirë sidomos nga ana kuptimore. (Camarda I 110, Tagliavini AD 112, Mjedja Leka IV 1932, 351, Çabej SE IV 86, Bokshi SFS 315).

ep ~ épem fol. “përkul, lakoj ~ përkulem, lakohem”. Fjalë e dy dialekteve. Lidhet përbrenda gjuhës me *jap* ~ *jep*, të cilat kanë marrë bashkëtingëlloren *j*- si protezë për të zhdukur hiatin e formuar në ngërthim të fjalisë (*nuk e j-ep*). Kësisoj, *ep* është forma e vjetër e foljes *jep*. Një lidhje tjetër brendagjuhësore e kësaj folje është me ndajfoljet *prap*, *prapa* e *mbrapsht* dhe mbiemrin *i prapë*, të gjitha nga *për* + *ap*, duke u bashkuar të gjitha këto në konceptin “kthej”. Me këtë formë e kuptim, *ep* ~ *ap* është fjalë e trashëguar, që lidhet me rrënjën ie. *epi*, *opi*, ku bëjnë pjesë got. *afta* “poshtë”, ags. *oeft* “prapa”. Një lidhje me gr. vj. σκαμβός “i përkulur” (Restelli) nuk përlligjet fonetikisht. Rrjedhoja të fjalës janë: *epje*, *epoj* “përkul, lakoj”, *i epët* “i përkulshëm”, *i paepur* “që s’epet, që s’thyer”, termat gramatikore *eptoj* “lakoj a zgjedhoj”, *eptim*, *i eptueshëm*. (Bopp 530, Meyer EW 13, Restelli RIL 89-90, 1956, 417, Çabej SE IV 88).

ërgjëz sh. “morra të vegjël që sapo kanë dalë nga thërija”. Është fjalë e mbarë gjuhës, me forma të ndryshme në të folme dialektore: *ërgjëz* gjithandej në Veri, *ërgjës* e *ëgjërs* në anët e Vlorës, *ërgje* në arbërishten e Kalabrisë. Përdoret vetëm si shumës, njëjësi i së cilës është *ërgull*. Te *ërgjëz* përkundrejt *ërgull* kemi metafoninë *a- : e-* dhe bashkëtingëllore qiellzore në vend të grykores (khs. *plak ~ pleq*). Prapashtesa *-zë* është formant shumësi (khs. *njerëz*). Duke u nisur nga rrënja *arg*, burimi i saj është ie. *er(e)g^h* “mori”, me të cilën lidhen lat. *ricinus* “rriqër”, lit. *ërke* “rriqër”, let. *ërce* “krimbi i lopës”, arm. *orjil*, ind. vj. *likšB* “thëri” (Bugge). Afrimi që bën Çabej me *arzë* (tosk.) e *anzë* (geg.), duke i futur të gjitha në një grup, nga një rrënjë ***anëg*, nuk qëndron, meqenëse *-r-ja* e *arzë-s* ka dalë me rotacizëm nga *-n-ja*, kurse *ërgull* e *ërgjëz* kanë një *-r-* të trashëguar, që e ka edhe gegërishtja. (Meyer EW 96, Pedersen KZ 36, 1900, 329, Hermann KZ 41, 1907, 48, Walde-Pokorny I 145, Walde-Hofmann II 433, Çabej SE IV 96, Demiraj AE 81, Topalli Hund. 108).

ërret “ngryset, bëhet natë”. Fjalë e mbarë gjuhës pa ndryshime dialektore, me burim të paqartë. Dëshmohej për herë të parë te Buzuku: *përse ata ernjënë faqenë e tyne*. Tek ky autor dhe të tjerët më vonë gjenden edhe mbiemrat *i errët* e *i errëshim* dhe emri asnjans të *errëtit*. Nga *err* është formuar *terr* (nga *t(ë) + err*) me rrjedhojat e shumta që ka krijuar (*terrí, terrinë, terrësi, terrní, terratis* etj.). Përbrenda gjuhës *err* lidhet me *rê* me burim nga ie. *erb^h*, në fjalë që shënojnë ngjyra, si: të kuqe, të errët, bojëkafë etj., ku bëjnë pjesë: isl. vj. *iapr* “bojëkafë”, gjerm. l. vj. *erpf* “i errët”, ags. *eorp, earp* “ngjyrë e errët në të zezë”; duke dalë të dyja këto nga e njëjta bazë, por me pozicione të ndryshme të theksit: folja *err* me theks nistor, kurse *rê*, që mund të jetë formë shumësi, me zhvendosjen e tij një rrokje më tej, si në rastin (*i*) *poshtë* ~ *pështjerë*. *R-ja* e thjeshtë te *rê* dëshmon se ka pasur një tingull përpara; kurse karakteri hundor është zhvillim i brendshëm i shqipes, si në rastin *ullî* (mbaresë e kallëzores së trashëguar *-om*). *Rr-ja* te *err* mund të ketë dalë nga pjesorja *er-në*, si te *marrë, bjerrë*. Sipas Çabejt *errët* e *rê* lidhen me gr. *ῥίως*, një shpjegim i vështirë fonetkisht. Rrjedhoja të fjalës janë: *errësoj* (*errësim, errësues*), *errësirë, errtas*. (Camarda I 83, Meyer EW 69, Jokl Stud. 21, IF 44, 1926, 49, Boisacq 1110, Walde-Pokorny II 367, Walde-Hofmann II 439, Cimochofski LP 2, 1950, 226, Çabej SE IV 98).

Ë

ënjtet / ájet fol. “fryhet, mbufatet”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar, por me forma të ndryshme në të dy dialektet, ku përdoret më shumë në kohët e

shkuara dhe në format joveprorë. E kanë edhe arbëreshët e diasporës, ku dalin edhe format *ëjem*, *i ëjtur*. Format e dy dialekteve ndihmojnë për hulumtimin e bazës së hershme. Zanorja *ë-* e toskërishtes përkundrejt *a-*së së gegërishtes dëshmon se rrënja e fjalës ka qenë një **an-*, e cila duke u bashkuar me mbaresën *-Ōō* të vetës I njëjës të së tashmes ka dhënë *-nj* (khs. *banj / bënj* nga **b^hanŌō*). Në gegërishte sonantja *-nj* ka kaluar në *-j-* si në rastet e tjera, gjë që ka ndikuar në çhundurëzimin e zanores *a-*, meqenëse nuk ndodhet më pranë një bashkëtingëlloreje hundore. Forma të tilla me zanoren *a-* gjenden edhe në toskërishte: *ajtem*, *m'u ajt dora* (Gjirokastër), *m'u ajtin glishtërit* (Çamëri), arbëreshët e Greqisë *ahet* për “ënjtet”. Këto forma, që janë të parregullta në atë dialekt, do të jenë rikthime të mëvonshme, forma të reja të krijuara sipas prirjes për të zëvendësuar zanoren *ë-* me *a-* si më shprehëse, sidomos në rastet kur ka humbur sonantja hundore. Forma *ënjt* e toskërishtes përmban prapashtesën e pjesores *to*, e cila edhe në folje të tjera ka hyrë në përbërjen e së kryerës së thjeshtë (khs. *mbajtë ~ mbajta*). Forma *ëhem* e këtij dialekti përmban tingullin *-h-* për zhdukje të hiatit (khs. *bëhem*). Fjala dokumentohet së pari në veprën “Çeta e profetëve” të Bogdanit (1685): *faqeja e tij gjithë ajtë*. Antonimi i fjalës është *çënjtet* (tosk.) ~ *shajet* (geg.). Për burimin e fjalës duhet marrë parasysh se të gjitha format kanë si bazë një rrënjë **an-*, që lidhet me ie. *an-* “marr frymë, fryj”, duke u bashkuar me ind. vj. *aniti* “merr frymë”, gr. ἄνεμος “frymë, erë”, lat. *anima* “shpirt, frymë”, irl. vj. *anāl* “shpirt”, got. *uzanan* “nxjerr frymë” etj. Lidhja me rrënjën ie. **oid-* “ënjtem”, ku bën pjesë arm. *aitnum*, gr. οἰδύω, lat. *aemidus*, gjerm. *Eiter* (Çabej), duket më e largët për shkak të karakterit hundor të fjalës së shqipes. (Meyer EW 5, Walde-Pokorny I 57, Huld BAE 63, Çabej SE IV 122, Demiraj AE 171).

F

fal fol. “e ndjej”, “dhuroj”, “bëj lutje fetare”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Dëshmohet së pari te Buzuku: *e tÿ t u enfalshin en gjindja*. Kuptimi i parë i foljes ka qenë konkret për “ulem, përulem, bie”. Kjo del në shprehjen *fali dielli* “perëndoi”, *falem* “lutem” në thelb “përkulem”. Me këtë kuptim konkret folja e shqipes mund të afrohet me rrënjën ie. *phol-* “bie”, ku bëjnë pjesë gjerm. l. vj., saks. vj. *fallan*, ags. *feallan*, isl. vj. *falla* “bie”, lit., let. *pūlu*, arm. *ϕul* “shembje” (Barić). Një lidhje me gr. σφάλλω “rrëzoi, përmbys” (Camarda, Çabej) duket më e largët. Rrjedhoja të fjalës janë: *falë* “dhurata e nuses”, *falje*, *i falshëm* e *i pafalshëm*, *falëtar* e *falatar* “ai që punon falas” (Malësi e Madhe), *falanik* e *falës* “zemërgjerë”, shumësi të *fala*, *faltore* e *faltar* “ai që bën shërbimet fetare në faltore”, *faltuar* “adhurues” (arb. e Italisë), *përfalem*, *faleminderit* e *faleminderës*, *falënderoj*,

falënderim e *falënderues*, *falëmeshëndet* etj. (Camarda I 79, Meyer EW 98, AS IV 61, Barić ARS I 24, Hómje 35, Skok ER I 696, Çabej SE IV 130, Orel AED 93).

fend fol. “pjerdh pa zë”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Lidhet me rrënjën **spend-* nga *spē(i)-* “tërheq”, ku bëjnë pjesë sll. vj. kisht. *pođiti* “shtyj, i grah”, *peđi* “tendos”, lit. *spëndziù* “ngreh një kurth”, gr. *πένομαι* “mundohem” gjerm. l. vj. *spannon*, *spinnan* “ndej, tendos” (Treimer). Një burim nga lat. *fimita*, rrjedhojë e *fimus* “mut, bajgë” (Çabej) paraqet vështirësi fonetike e kuptimore. Emri *fendë* është krijuar nga forma e pashtjelluar me përdorim emëror (khs. *pordhë*). Ndër rrjedhojat e shumta që ka krijuar fjala, vëmë në dukje formimet me prapashtesa: *fendac*, *fendcak*, *fëndosh*, *fëndanak*, *fëndek* (Vlorë), *fënuq* “frikacak” (Mirditë), *fendcan*, *fendç*, *fendçuk* e *fendçajkë* (Pejë); formime me parashtesa: *shfenc* (Velipojë) “një lloj shkurreje, lat. *Amopha fruticosa*”, *përfenden* “shkelen shpendtë”, *shkalafendet* “lodhet”, *shkarrafendem* “përplasem”; kompozitat: *fendosë* “një lloj këpurdhe, lat. *Bovista nigrescens*” nga *fendë* *dose*, me këtë kuptim edhe *fendujkë* e *fendarushë* me emrat *ujk* e *arushë*. (Meyer EW 101, Treimer KZ 65, 1938, 98, Çabej SE IV 159, Orel AED 95).

fice “i pjekur tepër, i zbutur, i rreshkur”. Fjalë krahinore e toskërishtes jugore. Është formim i brendshëm nga folja “fik”, që ka edhe kuptimin “thaj”; khs. *u fiknë ndresat* “u terën, u thanë” (Gjirokastër), *dardhë të fikura* “që janë lënë për t’u tharë”. Kështu, *dardha fice* është një me “dardha të fikura”, formim prapashtesor (*fik-ës-e*), ku *-e*-ja fundore është formant shumësi ose mocioni. Prej mbiemrit ka dalë folja *ficet* “zbutet, piqet tepër”.

firifiu mb. “me mendje të papjekur, mendjelehtë: *e ka mendjen firifiu*”. Fjalë me përhapje krahinore në të dy dialektet, e përbërë nga dy elemente (*firi* + *fiu*), me bazë onomatopeike si imitim i erës, nisur nga kuptimi “me mendje si era, si veriu”, khs. “i riu si veriu”. Elementi i parë krahasohet me *fërfërin*, *fërfëllin* etj., që kanë të njëjtën bazë onomatopeike. Te *firifiu* ka njëfarë harmonie vokalike. Përbrenda gjuhës *firifiu* afrohet me *firifyçkë* (tosk.), që e kanë të përbashkët elementin e parë formues. Në anët e Beratit *firifickë* del për “erë e lehtë”. (Luka II 34).

fishket fol. “humb freskinë, rrudhet, thahet”. Fjalë e dy dialekteve me forma të ndryshme, me burim të paqartë. Toskërishtja ka formën *fishket*, gegërishtja ka *veshket* e *vyshket*. Duke u nisur nga *veshket* e gegërishtes, fjala mund të lidhet me lat. *vescus* (Miklosich), që ka kuptimin “i dobët, i thatë”, ku

forma me *-i-* mund të ketë dalë nga trajta joveprore, kurse ajo me *-y-* nga veprimi i *v-së* me anë të asimilimit. Një lidhje tjetër brendagjuhësore mund të jetë me *i fishkët* “pa thelb” duke u bashkuar me *fyell* e *fyrbë* (Çabej). Më së fundi, mund të lidhet me *fik-sh* me metatezë *fishk* duke u lidhur me foljen *fik*, kuptimi i hershëm i së cilës ka qenë “thaj” (khs. *dardhë të fikura*). Rrjedhoja të fjalës janë: *fishkje*, *i fishkët*, *fishkaraq* “i thatë e plot rrudha, i mefshtë”, *fishkëz* “një sëmundje që fishk pambukun”. (Miklosich AF II 70, Meyer EW 468, Jokl IF 44, 1926, 35, Çabej SE IV 194, Orel AED 97).

fjalë f. “ajo që i thuhet një tjetri, thënie”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian, që dëshmohet së pari te Buzuku: *për një ças shkon fjala e t̄i e vete*. Lidhet përbrenda gjuhës me foljen *flas*, me një lidhje të tillë që të dyja kanë pasur si bazë një *-e-* të shkurtër indoeuropiane, e cila te *fjalë* ka dhënë *-ja-* (khs. *djalë*, *djathë*), ndërsa te folja është zhdukur kur e tashmja u zgjerua me prapashtesat *-as* ~ *-et* (*flas* ~ *flet*), por është ruajtur *-ë-ja* e gjatë, që ka evoluar në *-o-* në formën e së kryerës së thjeshtë *fol*, ku ka dalë me apofoni kuantitative nga *-e-ja* e shkurtër (*/e/* ~ */ē/*). Me këtë lidhje, folja dhe emri kanë pasur të njëjtën bazë, që në shkallë indoeuropiane lidhet me rrënjën **spel-* “flas me energji”, ku bëjnë pjesë got. *spill* “tregim, gojëdhënë, përrallë”, *spillōn* “shpall, njoftoj, tregoj”, nord. vj. *spiälla* “bisedoj”, ags. *sellian* “tregoj, bisedoj” (khs. ang. *spell* “shqiptoj”). Mendimi i disa gjuhëtarëve (Meyer, Pedersen, Çabej etj.), që i nxjerrin të dyja këto fjalë me burim latin, ecën nëpër vështirësi fonetike. Lat. *fabella* nuk mund të japë *fjalë*, se prej saj do të kishim një *-ē-* (të gjatë), që nuk mund të diftongohej në *-ja-* dhe me emrin *fjalë* nuk mund të shpjegohet e kryera e thjeshtë *fol*, pasi nuk ka analogji në gjuhën shqipe.

Rrjedhoja me karakter popullor të këtij emri janë: *fjalëz*, *fjalaman*, *fjalor*, *fjalos* (khs. *llafos*), *fjalëtor* “lajmës” e “pleqnar”; neologjizma janë: *fjali*, *fjalor* (*fjalorth*), *fjalim*, *fjalës*, *parafjalë*, *parafjalor* etj. (Meyer EW 106, Pedersen KZ 33, 1897, 536, Weigand Wört. 19, Jokl Zb. Beliću 1921, 45, Meyer-Lübke REW 3119, Treimer KZ 65, 1938, 103, Bartoli It. e Cr. 1942, 152, Haarmann Lat. Lehn. 124, Orel SBJ 1983, 146, Huld BAE 64, Çabej SE IV 196, Orel AED 98, Luka II 35).

fórbël f. “pjesët e qëruara të frutave (lëkura, zemra, farat). Fjalë krahinore e gegërishtes jugore, me burim të errët. Lidhet përbrenda gjuhës me *formël* “leskër lëkure, zbokth, pare peshku”, ku *-b-*ja është kthyer në *-m-*. Lidhje të tjera janë me *lëforë* “pare peshku, leskër” e *forlë* “lloj djathi” e “leskër”, e cila me metatezë ka dhënë edhe *folër* “toptha gjalpi të vegjël, që mbeten në kullësë” (Çabej). Kësisoj, *forbël* është formuar me prapashtesat *-bë*

e *-lë*, kjo e fundit me kuptim deminutiv. Rrënja e fjalës, një **for-*, mund të ketë dalë nga *thor* me kthimin *th- > f-* me karakter dialektor, duke u lidhur përbrenda gjuhës fonetiki me *thor* në *Qafa e Thores* dhe me *tërthuer ~ tërthore* dhe kuptimisht të gjitha këto me *therr* e *thërrime*, ku *forbël* del me kuptimet “diçka e prerë, e qëruar” dhe “thërrime, leskra”. (Meyer EW 110, Mann Dict. 113, Çabej SE IV 210, Orel AED 101).

fruth / frûth m. “sëmundje ngjitëse që prek fëmijët, lat. *Morbillus*”. Fjalë e mbarë gjuhës, në Veri me zanore hundore, në Jug me gojore. Është huazim nga lat. *forunculum* (khs. it. *foruncolo* “i thatë, lungë, çiban”), i emërtuar nga puçrrat që dalin. Prapashtesa deminutive e latinishtes është zëvendësuar me prapashtesën *-th* me të njëjtin kuptim. Në një grup prej tri bashkëtingëlloresh ka rënë *-k-*ja e mesit. Zanorja hundore në gegërishte dëshmon bazën e hershme me *-n-*, që ka rënë para *-th-*së (khs. *ûth* nga *un-th*). Çabej e nxjerr me një burim indoeuropian, nga rrënja **rud^h*- me kuptimin “i kuq”. (Meyer EW 154, Tagliavini AD 242, Çabej SE IV 216, Orel AED 103).

fshij fol. “pastroj me fshesë”. Fjalë e mbarë gjuhës me forma të ndryshme dialektore, të krijuara nga evolucioni i grupit *fsh-* në ballë të fjalës: *fshij* më fort në anët e Jugut dhe e përgjithësuar; me karakter dialektor *mshij*, *mbëshij*, *pshij*, *shij*. Fjalë me burim të paqartë. Përmban prapashtesën *f-*, kurse rrënja *shij* mund të jetë me karakter onomatopeik (khs. *shushurin* me përsëritje (reduplikacion) nga *shu-shu*, *fëshfërin* etj.). Bën pjesë në zgjedhimin me *-inj ~ in*, si në rastet e tjera të këtyre krijimeve. Në shkallë indoeuropiane e kanë lidhur me rrënjën **b^hes-* “pastroj duke fërkuar”, ku bën pjesë gjerm. l. vj. *bësamō*, ags. *bësma* “fshesë” (Meyer), një etimologji që shkon nga ana kuptimore, por jo edhe nga ana fonetike, meqenëse forma *bëshinj* nuk është parësore, por e dalë nga *(m)bë-shinj*. Dëshmohet së pari te Buzuku: *E tue ardhunë, e vjgân fshūtë e trajtuom*. Rrjedhoja të fjalës janë: *fshesë* me prapashtesën *-esë*, së cilës gegërishtja veriore i përgjigjet me *shisë* me prapashtesën *-së* nga pj. *shi*. Nga *fshesë* është formuar *fshesaxhi* me prapashtesën *-xhi* (me burim turk), si edhe neologjizmat *fshesar*, *fshesatore*, *fshesëtar*, *fshesurina* “të fshirat” (khs. *shkresurina*). Nga pjesorja toske *fshirë* janë formuar *fshirës* “pastrues” e *fëshirëse* “gomë që përdoret për të fshirë”. Me prapashtesën *për-* është formuar folja *përfshij* me rrjedhojat *përfshirje*, *përfshirës*. (Meyer EW 277, Treimer KZ 65, 1938, 78, Xhuvani-Çabej BSS 4, 1956, 15, 78, Mann Dict. Lg. 26, 1950, 388, Çabej SE I 108, Demiraj AE 173, Orel AED 104).

G

gabérr mb. “i trashë nga mendja, i pagdhendur”. Fjalë me përdorim të kufizuar në gegërishte. Është formim me parashtesën *ga-* nga emri *berr*, me kuptimin “bagëti, kafshë”, khs. *ka mbetë berr* “i pashkollë”.

gabzhérr m. “gypi që çon ajrin në mushkëri, rryl, skërfyell”. Fjalë e dy dialekteve, që del me forma të shumta e të ndryshme: krahas *gabzherr* edhe *gabzerr*, *kapzerr*, *gopzerr*, *gopzher*, *gopzherr*. Bazë e fjalës është emri *gop* me kuptimin “gyp”, që ka marrë prapashtesat *-sh*, *-er(r)*, kjo e fundit me geminacion afektiv. Rrënja e fjalës del edhe te *gopç* “grykës”, ku *-ç*-ja është një variant i prapashtesës *-sh*. Te *gabzherr* *-o*-ja e patheksuar është hapur në *-a-*. Çabej e lidh me *kapcere* “kapërcyell i gardhit”. (Çabej SE IV 235).

gargalíq m. “kafshë e vogël si bretkocë”. Fjalë e dialektit gegë. Është krijim i brendshëm me prapashtesën *-iq* nga një bazë onomatopeike, *gar-gar*, imitim i tingullit që lëshon bretkoca. Nga dy lëngëzoret e njëjta dridhëse, njëra është shndërruar në anësore me anë të disimilimit. Folja *gargarit* për “bërtasin bretkocat, kuak” ka të njëjtën bazë onomatopeike dhe prapashtesën *-it* (rrj. *gargaritje* e *gargalisje*). Me prapashtesë tjetër është ndërtuar nga e njëjta bazë *gargalec* (Dema).

gáshtë₁ f. “kupa e gjurit”. Fjalë e gegërishtes veriore, që ka edhe format *gazhdë*, *gaxhë*, *gashtellë* e *gashtull*. Te Fjalori i Da Lecces *gashta e gjunit* it. “rotula del ginocchio”. Te *gazhdë* kemi sonorizim të bashkëtingëlloreve të shurdhëta, prej së cilës ka dalë edhe *gaxhë* me shkrirjen e dy bashkëtingëlloreve (khs. *bazhdulidhe* e *baxhulidhe*) Forma *gashtellë* përmban prapashtesën *-ellë* (khs. *humbellë*), kurse *gashtull* ka prapashtesën *-ull*. Për burimin e fjalës, forma bazë është *gashtë*, që përmban parashtesën *g(ë)*- dhe emrin *asht* “eshtër”, si rrjedhim, *gashtë* është “ashti i gjurit”. Nga *gashtë* është formuar *gashtërr* (*gashtrra* e *gjunit*) me prapashtesën *-ërr* (khs. *kokërr*). Një burim prej foljes *shtjell* (Çabej) paraqitet më i largët kuptimisht dhe i vështirë fonetikisht për të shpjeguar të gjitha format e fjalës. (Çabej SE IV 246, Orel AED 110).

gáshtë₂ f. “gur i zi që përdoret për të provuar arin e argjendin, gur grihës”. Fjalë dialektore e gegërishtes veriore, që del më së pari te Kuvendi i Arbënit: *e sikūr provuem mbë gashtë të forcohen me Orakullitë pushtetesë sate*. E ka edhe Puka për “gur grihës”. Është formim i brendshëm me parashtesën *g(ë)*- dhe emrin *asht*, që është përdorur së lashti për të gërryer, gjë që e vërteton edhe emri *brisk* nga *bri* + *-sk*. Me këtë burim, lidhet përbrenda

gjuhës me *gashtë* “kupa e gjurit”, që gjëllin në gegërishten veriore, edhe kjo e formuar nga *asht*. Çabej e nxjerr nga *eh* prej një **ah*, që nuk ekziston në gjuhë. (Çabej SE IV 246).

gath m. “lulesë e varur si vile, lëvare”. Fjalë e rrallë me shtrirje krahinore në gegërishten veriore (Pukë). Lidhet përbrenda gjuhës me *gjeth*, duke përfaqësuar kjo e dyta formën e shumësit me metafoji, kurse ajo e para formën e njëjësit. Është fjalë me burim indoeuropian, që lidhet me rrënjën *glos-* “degë, gjethe” zgjeruar me *-d*, ku bëjnë pjesë serb. vj. *gvozd* “pyll”, pol. *gwozd* “pyll malor”, *gozd* “pyll i dendur”, gjermanik. *guast-* “tufë gjethesh” (Jokl). Një krahasim me got. *gazds* “thumb, ferrë”, gjerm. *Gerte* “thupër”, lat. *hasta* “purtekë, shkop, heshtë” (Çabej) është më i largët nga ana kuptimore, në një kohë që krahasimi me fjalët e sllavishtes e gjermanikishtes pajtohet më së miri kuptimisht e fonetiksht. (Pedersen KZ 33, 1897, 547, Jokl IF 30, 1912, 203, LKU 221, Walde-Pokorny I 644, Tagliavini AD 130, Çabej SE IV 325).

gërgalle f. “tokë gurishtë dhe e varfër, bokërimë”. Fjalë krahinore e gegërishtes veriore (Malësi e Madhe, Dukagjin). Lidhet përbrenda gjuhës me *rrëgallë* “vend i pjerrët, i mbushur me gurë të rrokullisur nga mali; rrëpirë” me ndërrim të parashtesës. Me këtë lidhet emri *gërgallinë* “copë toke, arë, ngastër e varfër e me gurë”, që ka pranë emrin *rrëgallinë* “vend rrëgallë, tokë e mbushur me gurë të sjellë nga ujërat”. Një lidhje me *gargull*, vazhdim i një forme *garg-alā* (Orel) nuk qëndron nga asnjë anë. (Orel AED 114).

gërthás fol. “bërtas, thërras”. Fjalë me përhapje krahinore në gegërishte, sidomos në Shqipëri të Mesme. Është formim me prapashtesën *-as / -et* nga një rrënjë *grith*, ku *gërth-as* nga *grith* ka dalë sikurse *bërtas* nga *brit* e *thërras* nga *thirr*. Bashkëtingëllorja *-th* mund të jetë prapashtesa *-t*, që në afërsi të një *-r*-je është shndërruar në *-th*. Rrënja *grith* lidhet përbrenda gjuhës me foljen *grith* “gërvisht, çjerr, lëshoj një zë të çjerrë: *grithte sharra, i grithnin mushkëritë*”, dhe të dyja këto mund të lidhen me *gri-j*, meqenëse folje të tilla kanë dalë nga fjalë me kuptimin “shqyej, gris” (khs. *thërras ~ thirra* nga *therr, grith* “çjerr”). Lidhja me *këlthas* e *këlcas* (Çabej) ndesh në vështirësi fonetike për punë të lëngëzoreve jo të njëjta. (Meyer EW 123, Weigand BA 3, 1927, 213, Çabej SE IV 261, Orel AED 116).

gërvisht fol. “çjerr pak, gërric”. Fjalë e mbarë shqipes. Dëshmohet së pari te Budi: *vāj e gjamë e të gërvishtunë* (RR). Përbëhet nga rrënja *gërvish* dhe prapashtesa *-t*, me burim nga pjesorja *gërvishtë* (ie. *to*). Folja mund të jetë huazim nga gr. γράφω “shkruaj”, që në gjuhën shqipe mund të ketë hyrë në

zgjedhimin e foljeve me *-is*, ato më të vjetrat me kthimin *-s > -sh*. Në një formë **grafis > gërvish* është errësuar zanorja e patheksuar dhe lëngëzorja ka lëvizur si në rastet e tjera. Një burim tjetër mund të jetë me karakter onomatopeik (Çabej). Gegërishtja veriore ka trajtën *gerdhísht* me kthimin *-v- > -dh-* në afërsi të *-r-së*. Prej foljes janë formuar emrat foljorë *gërvishtje* e *gërvishtës*. (Miklosich AF I 20, Meyer EW 125, Tagliavini AD 126, Çabej SE IV 262, Orel AED 116).

gërrýej fol. “kruaj nga brenda, brej”. Fjalë e mbarë gjuhës, me burim të diskutueshëm, që varet nga ndarja e fjalës në elemente formuese. Me një ndarje **gë-rryej* rrënja lidhet me foljen *rryej* “heq keq”, që është kuptimi figurativ, ndërsa kuptimi i parë konkret ka humbur. Me një ndarje tjetër, **gërr-yej*, rrënja lidhet me *grij* ose me *kruaj* (Meyer), ku vështirësitë fonetike janë të dukshme. Më së fundi, rrënja *gërr* mund të jetë edhe me burim onomatopeik, sikurse *gërric*. Dëshmohet së pari te Budi: *me e gërryem* (SC). Rrjedhoja të fjalës janë: *gërryerje*, *gërryes*, *i gërryeshëm*. Nga *gërryej*, duke lënë jashtë pjesën fundore, janë formuar: *gërresë* “vegël metalike që shërben për të gërryer; të kruarat e gjellës; vend i gërryer” me prapashtesën *-esë*; *gërranë* “vend i gërryer nga ujërat” me prapashtesën *-anë*, *gërrec* “gropë e vogël” me prapashtesën *-ec*, *gërreç* “kungull ujës, susak që shërben si enë për ujë”, emërtuar nga se është si të ishte gërryer përbrenda (bosh); *gërrellë* “zgavër e gërryer nga ujërat” me prapashtesën *-ellë* (Mirditë), *gërruall* “kade që bëhet duke gërryer një trung” dhe “vathë bagëtish” etj. (Meyer EW 130, AS V 79, Jokl Stud. 23, Çabej SE IV 263, Demiraj AE 177, Orel AED 116).

gëzhdáp m. “dru, dajak”. Fjalë krahinore e dialektit toskë (Tepelenë). Është formim i brendshëm me parashtesën *gë-* dhe foljen *zhdap*, *zhdëp* “e rrah fort dikë” me burim onomatopeik (*dap*, *dëp*). Lidhet përbrenda gjuhës me *zdap*, si emër “dajak, i gjatë, dru i trashë e i pagdhendur”, si folje “zhdëp, e rrah fort”.

gílcë f. “dell i fortë që lidh muskujt me eshtrat në kyçe, laku i kyçeve”. Fjalë e gegërishtes veriore, me të cilën shënohen diku dejet, diku nervat, gjithsesi “një zgjatim”. Është fjalë e trashëguar, që lidhet përbrenda gjuhës me *gisht* (më e vjetër *glisht*), më tej me *gjemb*, *gem* nga *glemb*, që i përkasin rrënjës *g^lel-* “shpoj”, ku bëjnë pjesë lit. *geliù*, *gelti* “shpoj”, *gelonìs* “thumb, gjemb”. Te *gílcë* prapashtesa *-cë* është shtuar relativisht vonë, prandaj *-l-*ja ka ruajtur pozicionin fillestar, kurse te *glisht* prapashtesa *-sht* është shtuar më herët, duke shkaktuar lëvizjen e lëngëzores (khs. *birë* e *brimë*). (Çabej SE IV 266, Orel AED 117).

gisht m. “zgjatimet e dorës”. Fjalë e mbarë gjuhës, forma më e hershme e së cilës ka qenë *glisht*, që e ka ruajtur çamërishtja dhe arbërishtja. Forma e sotme *gisht* ka kaluar nëpër **g-jisht*, sipas evolucionit të grupit bashkëtingëllor *gl-*, ku bashkëtingëllorja *-j-* më vonë ka rënë nga afërsia fonetike me zanoren *-i-* (khs. *Kiri* në dokumente mesjetare *Clyro*). Ky evolucion është kryer para shqipes së dokumentuar, meqenëse paraqitet i mbaruar te Buzuku, ku fjala dëshmohet për herë të parë: *E tash prifti kã me marë me dy gishta të tĩ pakëzë pështymë*. Është fjalë e trashëguar, që përmban prapashtesën *-sht* në një rrënjë **gil-* duke u lidhur përbrenda gjuhës me emrin *gilcë* (*gil-cë*) “dell që lidh muskujt me eshtrat në kyçe”, më tej me *gjemb*, *gem* nga *glemb*, që i përkasin rrënjës *g^lel-* “shpoj”, ku bëjnë pjesë lit. *geliù*, *gelti* “shpoj”, *gelonìs* “thumb, gjemb”. Te *glisht* prapashtesa *-sht* është shtuar më herët, duke shkaktuar lëvizjen e lëngëzores, kurse te *gilcë* prapashtesa *-cë* është shtuar më vonë, prandaj *-l-*ja ka ruajtur pozicionin fillestar (khs. *birë* e *brimë*). Rrjedhoja të fjalës janë: *gishtaq* “me 6 gishta në dorë a në këmbë”, *gishtar* “me formë të dorës”, *gishtas* “me gishta, gisht me gisht”, *gishtazi* “një lojë fëmijësh”; *gishte*, *gishtëz*, *gështezë*, *ngishte* e *ngizhde* “kësulë prej metali që vihet në majë të gishtit për ta mbrojtur kur qepim”; *gishtëz* “rrezja e rrotës së qerres”, *gishtje* “sharku i fortë, që mbështjell gjysmën e lendes së lisit”, *gishtor* “i gishtit”, *gishtore* “dorezë, dorashkë” etj. (Pedersen KZ 33, 1897, 547, Walde-Pokorny I 690, Demiraj AE 178, Orel AED 117).

glíqe f. “leqet e këmbëve”. Fjalë e gegërishtes veriore, e përgjithësuar në gjuhë. Është formim i brendshëm me parashtesën *gë-* dhe emrin *lak*, që në shumës bën *leqe* e *liqe*. Një lidhje përbrenda gjuhës me emrin *gilcë* “dell i fortë që lidh muskujt me eshtrat në kyçe” (Çabej), ka vështirësi nga ana fonetike. (Çabej SE IV 266, Orel AED 118).

gloq m. “sklepë”. Fjalë e gegërishtes që ka edhe trajtën *zgloq* me parashtesë dhe *gëluq* (Kristoforidhi). Është formim i brendshëm me parashtesën *gë-* nga një rrënjë **loq*, që ka formën e shumësit dhe lidhet përbrenda gjuhës me *loqe* “bole” (Orel), e cila përdoret zakonisht në shumës dhe në kuptimin më të përgjithshëm do të thotë “gjëndërr”, duke u lidhur me rrënjën ie. *lëuk-*, ku bën pjesë lit. *liaukà*, gr. *λεύκη* “një e dalë e bardhë, njollë e bardhë mbi lëkurë”. Një lidhje me *glepë* “lëng veshtullor që del në një anë të syrit” (Çabej) ka vështirësi nga ana fonetike, megjithëse në të dyja rastet kemi formime me parashtesën *gë-*. (Çabej SF 2, 1964, 30, Orel AED 119).

gómën “gropë në një lumë”, “pellg me ujë”. Fjalë dialektore e gegërishtes veriore. Është huazim nga sll. *glǫbina* “thellësi”, e cila ka pësuar

ndërrimin *-b-* > *-m-*. Grupi *gl-* i ballit të fjalës, që ka evoluar në *g-*, mund ta ketë burimin në gegërishten lindore, që mund të ketë qenë vatra e përhapjes së fjalës në të folme të tjera. Forma me bashkëtingëlloren *-b-*, që qëndrojnë më afër huazimit, gjenden te *gobën* “gropë e thellë ndër male”, *gobellë* “vend i thellë në ujë”, *zgobinetë* e *zgobinalle* “vend i mbushur me shkrepë e me gropa” etj. Fjala ka depërtuar në toponimi (*Gomna e Harapit* në afërsi të Shkodrës, *Gomenat* në Shqipërinë Veriore). Në këtë grup bën pjesë edhe toponimi *Gomsiqe* (Mirditë), i cili më 1638 dokumentohet në trajtën *Glomsichia*, si rrjedhim ka pasur grupin *gl-* (prapashtesën *-iqe* si në *gardhiqe*). Një burim nga emri *gop* (Çabej) nuk arrin të shpjegojë të gjitha trajtat e fjalës. (Çabej SE IV 274, Ylli SLA I 87).

grackë f. “betimë për të zënë zogj, minj etj., kurth”. Fjalë e dialektit toskë, e përgjithësuar në gjuhë. Mund të jetë formim me prapashtesën *-ckë* nga folja *grap* “kap me grep”, që e ka toskërishtja bashkë me arbërishten e Greqisë (khs. edhe *grapës* “vjedharak”) dhe ka karakter onomatopeik (khs. e *zura krap* “e kapa menjëherë”). Në një grup prej tri bashkëtingëlloresh ka rënë njëra prej tyre (**grap-ckë* > *grackë*). Me *grap* lidhet edhe *graps* “kruaj me thonj”, *grapcë* “copëz e vogël që i hiqet një sendi kur e gdhendin, gdhendël e imët”, që ka krijuar edhe foljen *grapcoj* “kafshoj pak nga pak me dhëmbë, gdhend pak e nga pak drurin”. Meyeri e nxjerr nga sll. (serb.) *grata* “kafaz, kangjellë” me burim prej it. *grata* “zgarrë”. Edhe në këtë rast fjala ka marrë prapashtesën *-ckë*, që ka krijuar një grup prej tri bashkëtingëlloresh, ku ka rënë njëra prej tyre. Një lidhje me *dërrasë* ose me foljen *ngre* (Çabej) duken të vështira. (Meyer EW 129, La Piana SLA Varia 97, Çabej SE IV 280, 282).

grafullón fol. “gufon uji, qumështi”, fig. “shfryn zemërimin”. Fjalë kryesisht e gegërishtes veriore. Lidhet përbrenda gjuhës me *gufon*, një zgjerim i saj me prapashtesën *-ull* në *gufullon* e më vonë në *grufullon* e *grafullon*, me shtesën e një *-r-*je (khs. *turfulloj* nga *tuf-ull-oj*, *murgullon* nga *mugullon*) dhe me hapjen e zanores *-u-* në *-a-*, si dukuri disimilimi. Foljen *me grufullue* e ka Gazulli për Malësi të Madhe me kuptimin “me çprushë si pulat, me çukërmue”. Emri *grafullim* është formim me prapashtesën *-im*. Prej *grafullon* ka dalë *grafull* “i fryrë” në Fjalorin e Bashkimit.

grah fol. “nxis një kafshë që të ecë, i bërtas, i thërras”. Fjalë e mbarë gjuhës me burim të paqartë. Dëshmohet së pari te Bogdani: *E Zotynë prej Sioni kã me grahunë*. Kuptimi i parë mund të jetë “thërras, ulurij”, që e kanë arbëreshët e Italisë: *grahu Turku si i tërbuam* (Kamsi), *grahmë* “britmë”; prandaj mund të jetë fjalë e trashëguar, e afërt me skt. *gṛāhi* “thërras”, lit. *giriù*, *girti* “lavdëroj, mburr”. Një lidhje me foljen *ngreh*, *ngre* (Çabej)

paraqitet e vështirë sidomos për anën kuptimore. Emrat *grahës* e *grahje* janë formime nga *grah*. Me këtë mund të lidhet folja *gërhas* “nxjerr zë në gjumë” me emrin *grahmë* “fryma e fundit para vdekjes”. (Camarda I 152, Meyer EW 128, Çabej SE IV 281, Orel AED 121).

grat m. “përfitim, dobi, dukë: *nuk i ka grat puna*”, *i gratshtëm* “i dobishëm, i frytshëm, pjellor: *tokë e gratshtëm*”. Fjalë e dialektit gegë, e përgjithësuar në gjuhë. Është huazim nga lat. *gratus* “i pëlqyeshëm, i këndshëm, i përshtatshëm”. Me këtë lidhet antonimi *ingratë* “i mjerë” nga lat. *ingrātus* “i papëlqyeshëm, i padobishëm”; kurse ndajfolja *gratis* “falas, pa pagesë”, që lidhet me këtë rrënjë të latinishtes, është huazim libror i ditëve tona. Prej *grat* është formuar brenda gjuhës *gratçor* “pjellor” (*tokë gratçore*), folja *gratoj* “kam fitim”, “përparoj në shëndet”, te Gazulli *graçoj* nga *gratshtëm*.

grúa / grúe f. “femër”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar. Dëshmohet për herë të parë në Fjalorthin e kalorësit gjerman Arnold von Harff (1497) me formën *growa*; më herët si patronim *Grouemiri* të dëshmuar në Kadastrën e Shkodrës (1416-17) nga emri i fshatit afër Koplikut. Buzuku e ka me *-uo*: *E erdh një gruo prej Samariet*. Lidhet me rrënjën *ger-*, ku bën pjesë gr. (at.) γράϋς “plakë” (Camarda). Ndryshimi në zanore ndërmjet njëjësit e shumësit shpjegohet me apofoninë kuantitative /a/ : /ā/, që në shqipe paraqitet /a/ : /o/ (*gra ~ grua*). Forma e njëjësit ka marrë brenda shqipes sonanten *-n*, në origjinë mbaresa e kallëzores së trashëguar, që del edhe në disa fjalë të tjera (khs. *drû*, *ullî*, *nye*). Rrjedhoja të fjalës janë: *gruar*, *granues* (te Bardhi), *granî* / *grarî*, *granisht* (Bardhi) / *grarisht*, *grunohem* “rrihem e bëhem grua”. Ka depërtuar edhe në toponimi: *Gruemirë*, një fshat pranë Koplikut të Shkodrës. Burimi i fjalës së shqipes nga greqishtja e vjetër (Çabej) nuk ka gjasa, duke marrë parasysh ndryshimet ndërmjet njëjësit e shumësit, që nuk kanë përfshirë huazimet historike. (Camarda I 39, Meyer EW 132, AS IV 39, Pedersen KG I 154, Barić ARS I 71, Tagliavini AD 126, La Piana SLA I 20, Mann Dict. Lg. 26, 1950, 381, Çabej SE IV 294, Demiraj AE 180, Orel AED 125, Luka X 90).

grúmbull m. “tog, grup, tufë”. Fjalë e mbarë gjuhës. Është huazim nga lat. *cumulus* “grumbull” me epentezën e *-r-së* në një fjalë me një lëngëzore tjetër (khs. *mjergull* nga *mjegull*, *tartull* nga *tatull*, *kruspull* nga *kuspull*). Ka marrë epentezën e një *-b-je* pas *-m-së* (khs. *kumbull* nga gr. vj. κοκκύμυλλο). Burimi nga një krijim elementar (Çabej) është mjaft hipotetik. Format *gërrumbull*, *garrumbull* e *grambull* janë zhvillime dialektore të *grumbull-it*. Dëshmohet së pari te Bardhi: *grumbullë* lat. “modius”. Rrjedhoja të fjalës janë:

grumbulloj (te Bardhi), *grumbullim*, *grumbullues*, *grumbullor* “që ka trajtë të rumbullakët, i mbushur, si top”, *grumbullore* “drurë që rriten si kaçubë, tufshak”, “buçkan”; në Kosovë *grumbullajkë* “grua e kërrusur” e *grumbullan* “gungaç”, *grumbulluç* “i rrudhur”, të gjitha nga kuptimi “i mbledhur”. (Miklosich AF II 31, Meyer EW 132, Helbig 88, Meyer-Lübke Gröbers Gr. I² 1904-1906, 1049, Weigand Wört. 24, Çabej SE IV 296, Orel AED 125).

grremç m. “degëzim në një dru”, “çengel”, “kërrabëz”, “sfurk”. Fjalë dialektore e gegërishtes, që ka si kuptim kryesor “degëzim i një druje”. Është formim i brendshëm me prapashtesat *gë-* dhe *-ç* nga emri *rrem*, forma dialektore geqe për *rremb* “degë e hollë, bisk, degëzim nga një trung” (nga lat. *ramus* “degë”). Rrjedhoja të fjalës janë: *grremçak* “që ka grremça”, *grremçe* “dhi me brirë të kthyer si grremç”, *grremçoj* “e bëj diçka si grremç”, *grremçore* “sfurk me grremç”. Format pa prapashtesën *-ç* gjenden te mbiemri *i grremtë* “i kërrusur, i përkulur si grremç”, ndajfolja *grremtas* “me trup të përkulur”, folja *grremtohem* “përkulem”. Çabej e lidh me emrin *greq*. (Çabej SE IV 298).

gúall m. “mbulesë e fortë prej kocke, që kanë disa kafshë të vogla, guaskë, zhguall”. Fjalë e toskërishtes, siç e dëshmon togu zanor *-ua-*, që i përket atij dialekti, i formuar nga diftongimi i zanores *-o-* para *-ll-*së (khs. *kapruall*). Si rrjedhim, edhe fjalët që lidhen me të dhe kanë këtë tog zanor janë të toskërishtes, si: *zhguall*, *guazë* e *guaskë*. Gegërishtja këtyre fjalëve u përgjigjet me *gocë* (deti) nga **goll-cë*, ku zanorja *-o-* nuk është diftonguar, meqenëse ndodhej në kushte të tjera për shkak të prapashtesës *-cë*. Duke i vënë këto forma në emërues të përbashkët, për të dy dialektet rrënja ka qenë **gol-* > *goll-*, që përbrenda gjuhës afrohet me *gojë* (çam. *golë*) me kuptimin e një zgavre. Për kuptimin “zgavër, boshllëk” khs. te Kristoforidhi: *guall* “lëvozhgë e arrës që masin farën e mëndafshit”, *guall breshke* “kafka e breshkës së ngordhur”. (Orel AED 126).

guáskë f. “mbulesë e fortë prej lënde gëlqerore që kanë disa kafshë të vogla mbi trup për t’u mbrojtur: *guaskë deti*”, “lëvozhgë e fortë që mbështjell frytet a farat e disa pemëve e drurëve, shark: *guaskë arre*”, “kore: *guaska e tokës*”, “bërthamë: *guaskë ulliri*”. Fjalë e toskërishtes e përgjithësuar në gjuhë. Është formim i brendshëm nga *guall* me prapashtesën *-skë*. Në një grup prej tri bashkëtingëlloresh ka rënë njëra prej tyre. Nga *guaskë* është formuar *guaskor*. Një tjetër formë e *guaskë-s* është *guazë*, që ka marrë prapashtesën deminutive.

gûçë f. “lëvozhga e fortë e disa frutave, gungë: *gûça e arrës*”; si mbiemër *guçe*. Fjalë e të folmeve geqe verilindore. Është formim i brendshëm me prapashtesën *-çë* nga *gungë* me kuptimin “gungçë” me rënie

bashkëtingëlloresh në grupin e formuar; khs. *arrë gungçe* “me lëvozhgë të fortë, që nuk thyhet lehtë”, me këtë kuptim edhe *arrë gûçe*. Një rrjedhje e fjalës është *guçël* për “zhubër, rrudhë në një petk” me prapashtesë deminutive. Me *guçë* lidhet *guxhë* “copë druri e rrumbullakët si top, nyjë”, me kthimin e bashkëtingëllores së shurdhët të prapashtesës në të zëshme.

gúrrë f. “burim, amë, krua”. Fjalë e mbarë gjuhës, me burim onomatopeik, imitim i zërit të ujit që rrjedh, nga një bazë **gur*. Forma *gurrë* mund të ketë dalë nga rasa kallëzore **gur-në* me asimilim *-rn-* > *-rr-* (Çabej). Lidhet përbrenda gjuhës me *gurgulloj*, që është formuar me dyfishim (reduplikacion). Dëshmohet së pari te Buzuku: *e aj t i shpjerë guravet me ujë*. Më herët (1485) del si patronim (*Vuk Gurra*). Formime nga kjo fjalë janë: *gurrëz* me prapashtesë deminutive, *gurrec* e *gurreç* “gurrë e vogël”, *gurrel* “lug druri ku bie uji i kroit”, në Kosovë edhe për “hurbë”, për të cilën ka edhe *gurrç*; *gurril* “curril” (Cordignano), *gurrëni* “vala e ujit të detit a të lumit, vorbull uji”, *gurron* “buron”, kompozita *gurrështerpë* “gurrë që shteron verës”. Arbëreshët e Greqisë e kanë për emrin e një gurre (Γκούρα). Në Jug del edhe si patronim. (Camarda I 72, Meyer EW 135, Çabej SE IV 307).

SUMMARY

FROM “ETYMOLOGICAL DICTIONARY OF ALBANIAN” III

davarít < *dvar-it*; **dëbój** from *dë-* + *boj*; **dënésë** from *dë-ne-së* (*nye ~ neu*); **di**: IE *dʰi-*, Ind. *dhī, dhītī*; **diell**: IE **m^hel-*, Ind. *hári*, Av. *zaray-* Gr. *χόλος*, OHG *gold*; **dje**: IE *ǵh[dŌ]es, ǵhjes*, Ind. *hyás*, Pers. *dī*, Gr. *χθες*, Lat. *heri*, OHG *gestre*; Dan. *igaar*; **djep** from An. Gr. *δέπας*; **dókë** from **dorkë* “hand”; **dókërr** from *dorë* “hand”; **dómën** “doubt” from *dy* > *dö* > *do* + *-m* + *-ën*; **drédhëz** from the verb *dredh*; **dríthë**: IE *ǵʰzd-*, Lat. *hordeum*, Gr. *κρί, κριθή*, OHG *gersta*; **dry** from *dru ~ drynjb* (pl.); **dúa / dúe**: IE *ǵeus-*, A2v. *zaosa*, Pers. *daustar*, Ind. *jusáte*, Gr. *γεύω*, Lat. *gusto, -āre*; **dýllë**: IE *ǵ^hel-, ǵ^hōl-*, Ind. *hári*, Av. *zaray-*, Gr. *χόλος*, OHG *gold*; **dhi**: IE *ǵ^haido*, Lat. *haedus*, Goth. *gaitis*; **e**: IE *ōā* (Meyer); **éja** < *e-ja* : IE *eŌ-*, Ind. *ǵti*, Av. *aēiti*, Pers. *aitiy*, Lit. *eimì*, Gr. *εἶμ*, Lat. *eo*; **end** < *end* “pollen”; **endé** from *end* + *e*; **éndem** from *end* “knit”; **(e) énjte**: *anj-te* from the verb *anj*; **ep ~ épem**: IE *epi, opi*, Goth. *afta* AGS *oefit*; **érgjëz** (pl.) < *argull* : IE *er(e)g^h-*, Lat. *ricinus*, Lith. *érke*, Latv. *ērce*, Arm. *orjil*, Ind. *likšB*; **érret** : IE *erb^h-*, Isl. *iapr* OHG *erpf*, AGS *eorp*, *earp*; **Knjtet / ájet**: IE *an-*, Ind. *aniti*, Gr. *ἄνεμος*, Lat. *anima*, Ir. *anāl* “shpirt”, Goth. *uz-anan*; **fal**: IE *phol-*, OHG *fallan*, AGS *feallan*, Isl. *falla*, Lith., Latv. *pūlu*, Arm. *ψul*; **fend**: IE **spend-* from *spē(i)-*, OSC *pođiti, peđi*, Lith.

spéndziù, Gr. πένομαι, OHG *spannon*, *spinnan*; **fice** from *fik* “dry”; **firifíu** onomat., **físhket** < Lat. *vescus*, or from *fyell* and *fyrbë*; (Çabej); **fjálë**: IE **spel-*, Goth. *spill*, *spillōn*, ON *spialla*, AGS *sellian*, (cf. Eng. *spell*); **fórbël** from *formël*, *lëforë* and *forlë*; **fruth** / **frûth** from Lat. *forunculum* (cf. It. *foruncolo*); **fshij**: IE **b^hes-*; **gabérr** < *ga-* + *berr*; **gabzhérr** from *gop* + *-sh* + *-er(r)*; **gargalíq** < *gar-gar* (onomat.); **gáshtë₁** “knee-cap” from *g(ë)-* + *asht*; **gáshtë₂** “grindstone” from *g(ë)-* + *asht*; **gath**: IE *g^hos-*, Serb. *gvozd*, Pol. *gwozd*, *gozd* (Jokl); **gërgállë** from *rrëgallë*; **gërthás** from *grith*; **gërvísh** from Gr. γράφω; **gërrýej** from **gë-rrýej*; **gëzhdáp** from *gë-* + *zhdap*; **gúlcë**: IE Lith. *geliù*, *gelti*, *gelonìs*; **gisht** from *glisht*: Lith. *geliù*, *gelti*, *gelonìs*; **glíqe** from *gë-* + *liqe* (pl.); **gloq** from *gë-* + **loq* (cf. *loqe*) : IE *lēuk-*, Lith. *liaukà*, Gr. λεύκη; **gómën** from Sl. *glōbina*; **grackë** from **grap-ckë*; **grafullón** from *gufon*; **grah**: Ind. *gr̥n̥ḅti*, Lith. *giriù*, *gìrti*; **grat** from Lat. *gratus*; **grúa** / **grúe**: IE *g^her-*, Gr. γράϝς; **grúmbull** from Lat. *cumulus*; **grremç** < *rrem* + *-ç*; **gúall** < **gol-* (cf. *gojë* “mouth”); **guáskë** < *guall* + *-skë*; **gûçë** < *gungë* + *-çë*; **gúrrë** onomat.